

EVALDA PACI

INSTITUCIONE THEMELORE TË ANTIKITETIT NË PËRPILIMET E SHKRIMTARINË E E. HAXHIADEMIT

Abstrakt

Në shqipërimet e E. Haxhiademit gjurmohen elemente të gërshetuara të botës antike, asaj greke dhe asaj romake. Formimi klasik i autorit reflektohet në aspekte të formës e të përmbajtjes, aq më tepër nëse kemi parasysh ndërtimin e vepërave që mbajnë emrin e tij e që mbështeten në motive të njohura të mitologjisë antike. Edhe në rasë të trajtimit e të vënies në qendër të veprës së personazheve që janë themelore në ngjarje madhore të përshkruara në letërsinë antike greke, por dhe në atë romake, autori spikat për një regjest emërtimeve e përveçimesh që lidhen pikërisht me një formim të tillë, të veçantë dhe unik në shumë vështrime. Në vepërzat e Haxhiademit, të titulluara dhe me emrat e vetë personazheve të tij, të tilla motive, që janë ndërthurje e elementeve qenësore të dy botëve, gjurmohen në disa aspekte: në ndërtimin metrik, por dhe në atë tekstual e përmbajtësor. Këto tipare i vëmë në dukje dhe në këtë trajtesë sintetike tonën, që iu kushtua në veçanti reflektimit të institucioneve të antikitetit në shkrimtarinë e këtij të fundit.

Fjalë kyçe: *formim klasik, antikitet, botë greke, botë romake, personazhe qendrore*

Në hapat e parë të përvijimit të kësaj trajtese, jemi ndier të dyzuar ndaj shtjellimit të një sërë elementesh që ofrohen gjerësisht në përpilimet aq të realizuara të një autori që ka riardhur në vëmendjen tonë në gjithë hijeshinë e mozaikut të veprave të tij, diskrete në numër dhe në motive trajtimi. Vetë periodha në të cilën një autor si Haxhiademi gjeti hapësirë e frymëzim për të reflektuar në krijimtari një sërë motivesh e subjektshës është e shënuar në letërsinë tonë nga një prodhimtari e pasur në tituj veprash e përpilimesh, nga sprovat për të konkretizuar në gjini letrare ngërthime ngjarjesh e rrethanash, si dhe për t'i dhënë pikërisht letërsisë antike një vend të merituar edhe në vëllime antologjike, qoftë dhe me destinacion shkollor.

Në rastin e Haxhiademit, pikërisht me vepërza që mbajnë titullin e personazheve që e kanë frymëzuar ndjeshëm këtë të fundit, do të kishim të bënim me “autorësi” të profilizuar mbi motivin e historisë jetësore të individëve që personifikuan në vijimësi veti e virtyte që më tej u ngulitën si

karakteriale, por dhe simbolike në regjistra e glosarë të lidhur ngushtësisht me mitologjinë e antikitetin grek e romak. Edhe nëse shihen thjesht si emra të përveçëm, gjithsesi ata përbëjnë shtysën për të kujtuar që rreth tyre u fol e u rrëfye pafundësisht që në vetë kohët e lashta, aq më tepër në rrethanat e hapësirave për interpretim që lejonte vetë mospërmbushja në detaje në veprat në të cilat së pari bëhet fjalë për ta e për protagonizmin përkatës të tyre. Cilësitë individuale që më tej do të jenë pjesë e një simbologjie të veçantë dhe në nëndisiplina të studimit të psikologjisë njerëzore nënvizohen në veçanti në krerë të veprave të Homerit, bashkë me rimarrje episodesh në secilën prej tyre.

Personazhet qendrore të përpilimeve të Haxhiademit në të vërtetë janë zërat më të plotë për nga vëmendja e rimarrjet, apo dhe interpretimet shpesh të ndryshme në dictionarët më të mirë të mitologjisë antike, fakt që rikonfirmon dhe rëndësinë që kësaj të fundit i jepej në studimet mbi antikitetin dhe kategorizimet mbi nocionet e normat themelore në këtë të fundit¹.

Duke i rimarrë dhe në këtë vështrim tonin të tilla individualitete që evokojnë tipare qenësore të natyrës njerëzore, do të duhej sërish të nënvizonim që me ta lidhet përherë personifikimi i mençurisë jo të zakonit që ndikoi në fatet e luftës së Trojës, i fathumburit që rrugëtoi gjatë dhe ofroi modele të një perkursi gjeografik në antikitet të motivuar nën vështirësitë që sillte ndeshja e tij me madhësinë e hyjnive, duke bërë të ndërthuren emra, imagjinime mbi vise të panjohura, por të perceptueshme mbi rrëfimin që ofronte vepra e një aedi mjaft të përmendur në antikitet.²

Nga ana tjetër, realizimi i analizave reflektuese të personazheve gjithnjë qendrore në krijimtarinë e Haxhiademit mund të sjellë vend për interpretime të vetë autorit mbi të njëjtat çështje, aq më tepër kur këto të fundit janë të një mprehtësie të denjë për t'iu referuar kodeve zakonore, koncepteve që të ngulitura thellë në psiken njerëzore, kanë nxitur një ndjeshmëri jo të zakonit që në kohët më të lashta të historisë së njerëzimit.

Çdo rimarrje e perkursit jetësor të personazheve që u ndërmendën kaq gjatë bashkë me vetë kryeveprat e letërsisë antike greke, të transmetuara në medime të natyrës didaktike, universitare, pasuniversitare u ka dhënë dorë e mundësi autorëve që ndiheshin kaq të lidhur me këtë traditë letrare të personalizojnë mbi detaje që në të vërtetë për vetë natyrën e të sipërcituarave,

¹ Shih në veçanti *Mitologia, I miti greco-romani raccontati da Pierre Grimal, Dei, eroi, temi leggendari; genealogie, fonti letterarie*, Garzanti editore, Brescia, 2000, f. 626-638.

² Haxhiademi, përpilues i një lënde të pasur në pikëpamje motivesh, me origjinë në antikitetin grek, ka qenë thellësisht i prirur ndaj shtysash për të rimarrë personazhe, sprova, qëllime që në të vërtetë janë dhe filli lidhës me projektimin e këtij të fundit në ditët tona, por dhe me kohën kur jetoi e krijoi autori ynë.

kanë qenë shtysë për pikëpyetje apo mbajtje pezull të vëmendjes së lexuesve a studiuesve më të përkushtuar të kësaj letërsie.

Në rastin e Haxhiademit, mund të thuhet se lidhjet e tij jo vetëm me motivet e veçanta, por dhe me kryeveprat në të cilat personazhet e tij kanë një rol qenësor në kuptimin e gjithë ecurisë së përmbajtjes, janë të natyrshme dhe po aq natyrshëm rimerren në pasazhet e përpilimeve të tij në dekadat e para të shekullit të kaluar. Këto përpilime mbeten të rëndësishme për t'u parë në aspektet që kanë të bëjnë thellësisht me rrugëtimin individual të autorit, por paraqiten dhe të pashkëputshme me realizime të afërta në kohë (qoftë dhe me shqipërimet përkatëse), që nuk janë dëshmi të thjeshta e as të veçuara të shfaqjes së interesit ndaj antikitetit dhe motiveve të tij.

Një aspekt i ndryshëm, por që nuk ndahet dot nga çka thuhet më sipër mbi Haxhiademin do të dalë në pah qoftë në parathënien e plotë me të cilën introduktohen Bukolikët e Vergilit, ashtu dhe në renditjen dhe sjelljen e eklogave përkatëse në një gjuhë të pasur, por që dëshmon një vëmendje të qartë ndaj kontekstit, shtysave të brendshme të autorit latin që përjetoi në të gjitha dimensionet sundimin dhe fuqizimin e Oktavianit drejt një apogjeu pushtetor që do të konkretizohej dhe me përpilimin e Eneidës, veprës më famëmirë të tij.

Jemi ndalur gjatë dhe në shqipërimin e Bukolikave nga Haxhiademi, duke pasur parasysh dhe diversitetin kompozicional të këtyre të fundit nga vepra që lartëson në 12 libra projektin për të interpretuar origjinën e Romës dhe më tej, lartësimin e personazheve që e simbolizojnë Romën në krejt madhështinë e ardhshme të saj, të iniciuar me mbretër legjendarë, të vijuar me dinasti etruske, të përforcuar me figura konkrete reformatore shtetërore e politike, që kësaj të fundit nuk i munguan asnjëherë, në veçanti në periudhat e lidhura mirëfilli me lashtësinë dhe klasicitetin.

Haxhiademi ofron një kompleksitet shfaqjesh të motiveve të botës antike, që nuk mund të ndahet dhe aq lehtë në përkatësinë ndaj greqitetit dhe romanitetit, aq më tepër që dallimet përkatëse mund të jenë dhe më të thella në vështrime të orientuara ndaj institucioneve themelore të secilit. Në të vërtetë, motive, ngjarje që shënuan fatet e popujve dhe etnive më të përmendura në antikitet, janë përpunuar thellësisht dhe gjerësisht në projektet e krijimtarisë së Haxhiademit dhe vetëm ky argument i fundit mund të përbënte një shtysë më vete për të sendërtuar një trajtesë të plotë mbi ndikimet e qarta që një formim i marrë në mënyrë sistematike, por dhe shënues në krejt rrugëtimin individual të tij ka luajtur ndjeshëm në krejt performimet letrare dhe artistike përkatëse.

Rrugëtimi i çdo përpilimi të Haxhiademit është një histori letrare më vete, që nxit kureshtjen e studiuesit dhe pas kaq dekadash që na ndajnë nga inicimi dhe përvijimi i secilit. Ka shumë hollësi për të vënë në dukje, ka përherë hapësirë për të reflektuar mbi zgjidhjet e Haxhiademit, por dhe mbi lidhjen e qartë të tij me fije tematike që në të vërtetë kanë qenë motivuese për shumë

autorë që në krijimtarinë e tyre gjetën në një botë kaq të pasur me subjekte lëndën e veprave më të rëndësishme të rrugëtimit të tyre krijues.

Konteksti në të cilin përpilohen të tilla vepra ka qenë i tillë që në një vijimësi në vite, mund të gjejmë në pikëpamje referimi jo pak rimarrje të motiveve që shtynë në transpozime subjektsh dhe rikthim të vëmendjes ndaj personazhesh që qysh në zanafillë të përfshirjes së tyre nga autorët më të hershëm, do të personifikonin me emrin, historinë e jetës dhe profilin si aktorë të një trame më të gjerë një simbologji më vete, që do të jetë nënteksti i një bote që konkretizohet në birin që vjen nga larg e do të ndjekë fatin për të qenë më tej i ndërmendur si patricid, në udhëtarin që sërish në ndjekje të fatit do të ndalet vend më vend për të mbetur pjesë e kujtesës historike të itinerareve më të ndërmendura në rrëfimet e legjendat mbi antikitetin, në personazhin që dhe pse i njohur për fuqinë e pazakontë fizike dhe impaktin në fatet e një lufte famëmadhe, do të ketë dobësitë e veta që e bëjnë të brishtë dhe në fund të thyeshëm e të vdekshëm.³

Falë personazheve që janë qendrore në veprat të cilat dhe Haxhiademi i deshi e i bëri të vetat në çdo dimension të mundshëm, përshkruajmë rrugëtime të një interesi të veçantë kulturor, që bëjnë të jenë pjesë e një konteksti kërkimor vise, gadishuj, ngulime, fortifikime që më tej dhe do të quhen me emrat e tyre.

Është më se e qartë që dimensionet në të cilat antikiteti gjen hapësirë shtrirjeje e shtjellimi janë mjaft të gjera dhe në rasë të krijimtarisë nga ana e Haxhiademit, i cili ndërmerr të tilla sprova në një moshë krejt të re, e cila motivon ndër të tjera një frymëzim kaq të pastër e genuin, dhe pse ndikimet nga formimi i marrë receptohen në elemente të ndërtimit të tekstit, të përzgjedhjes së formave dhe trajtëformave, por dhe në ndërtime që dhe pse me origjinë nga një botë e afërt, jo përherë përkojnë me vetë fillin tematik të veprës.

Mbetet për t'u sqaruar apo e denjë për interpretim prania e përveçimeve me një referencë të qartë ndaj panteonit romak në vepra që qysh në shtysë të përpilimit lidhen natyrshëm me botën greke dhe me krejt frymën e përjetimit të raportit me hyjnitë dhe me natyrën supreme të tyre.⁴ Ndër të tjera, jashtë çdo

³ Shih në veçanti E. Haxhiademi, *Akili, Tragedi me pesë akte*, Vjenë, 1925, botuar prej Shtypshkronjës Luarasi, Tiranë, 1931, f. 34-35.

⁴ Në një variant të romanizuar vjen dhe përveçimi *Ulisi*, së pari si një titull vepre dhe më tej si emër i një personazhi mjaft të kujdesuar e të trajtuar nga ana e Haxhiademit. Shih në veçanti E. Haxhiademi, *Ulisi, Tragedi me pesë akte*, Berlin, 1924, botuar prej Shtypshkronjës Luarasi, Tiranë, 1931. Sa u përket emërtimeve të hyjnive, përveç Minervës, perëndeshë (që me këtë emër mbahet si italike) që njihet se e mbron Uliksin, Jovi/Jupiteri, Neptuni, Merkuri, (por jo Afërdita; sic!) janë ndër të tjera disa përveçime që e provojnë një fakt të tillë, që duhet parë si tjetër provë veçanësie e formimit të

dysimi trajta të veçanta fjalësh mund të trajtohen si zgjedhje të vetë autorit, aq më tepër që duke qenë greke në koncept, paraqiten latine në formë dhe më tej, në atë përbërje në të cilën kanë ardhur në shqipen e tij. Një mendim i tillë na përforcohet dhe në rrethanat në të cilat i njëjti rast rimerret më se një herë, sidomos në përbërje vargjesh që ndërtojnë pjesë të afërta e që për autorin kanë një lidhje më se të motivuar përmbajtësore e që ndikojnë gradualisht në krejt ecurinë e rrjedhës së ngjarjeve. Ka një koherencë sa të natyrshme, aq dhe reflektuese të njohjes së thelluar nga ana e tij e kësaj bote të pasur me elemente mitike, që kanë gjetur në vijimësi kaq shumë interpretime sa të jenë shkak për konsolidimin e disiplinave studimore mbi antropologjinë e antikitetit dhe nocioneve themelore të tij.

Vepërzat në të cilat sprovat në fushë të shkrimtarisë nga ana e Haxhiademit paraqiten si ndërmarrje sa serioze, aq dhe dëshmi e një përballjeje me një sërë elementesh të formës e të përmbajtjes, përbëjnë dhe një arenë në të cilën do të gjejnë frymëmarrje elemente të një shprehësie të qartë artistike, por dhe të një bote që në variantet origjinale në të cilat i këndohej apo celebruhej, vetë gjuha përbënte artificin e parë që i jepte asaj gjithë kompleksitetin me të cilin vijon të konceptohet e rimerret dhe sot e kësaj dite.

Në sprovat e Haxhiademit është e mundur që ky kompleksitet të transmetohet dhe në gjuhën shqipe, dhe pse nuk mungojnë ndërtime me një lidhje të qartë me botën antike dhe kuadrin e pasur antropokulturor të saj.

Haxhiademi rishënon natyrshëm diakroninë e trajtave të shqipes, që do t'i gjejnë të reflektuara që në veprat e letërsisë së vjetër shqipe⁵. Duke i gjetur të sjella me një konotacion të ngjashëm, vërejmë me pozitivitet që ky autor u bë kontribues i të njëjtit mision të pasurimit të gjuhës së vet amtare, aq më tepër që një ndërmarrje të tillë ia mundësoi pasioni për letërsinë antike dhe veprat më të rëndësishme të saj.

Veprat më të hershme të letërsisë antike greke janë monumente letrare të cilat i madhështon po aq dhe vetë konvertimi e transmetimi i tyre në formë të shkruar, që ndër të tjera reflektoi dhe sa shumë të tilla përpilime u trashëguan në shekuj, duke kaluar dhe provat e punës së mundimshme të kopistëve, që më vonë u vijua nga shtypshkrimi, i cili u shënua dhe me rimarrje të autorëve

autorit. Një panteon i tillë gjen konfirmim të qartë dhe në pasazhet e tragjedisë me pesë akte me titull *Akili*, botuar në vitin 1931, por që rezulton e përpiluar prej autorit Haxhiademi që në vitin 1926. Shih në veçanti në këtë botim (*Akili*, Tiranë, 1931, f. 35), pasazhin e mëposhtëm: Tri hyjnesha qi kujtoshin/ se çmimn' e parë për bukurin fitoshin/ u kapën për të marr' këtë moll' ahë/ tyke u zan' e tyke bā potere./ Kto qen': Junona dhe Minerv'e zgjutë/ dhe Afërdit' hijeshme trupbutë.

⁵ Shih në veçanti përdorimin në shumës të fjalës *shqemb* në E. Haxhiademi, *Ulisi, Tragedi me pesë akte*, Berlin, 1924, botuar prej Shtypshkronjës Luarasi, Tiranë, 1931, f. 5.

antikë në motivet më të njohura të shkrimtarisë përkatëse.⁶ Nga ana tjetër, vetë sprovat që në kohët e lashta për të gjetur interpretime të munguara apo të pashprehura në brendinë e veprave më të rëndësishme të letërsisë antike greke qenë një tjetër dëshmi e interesit të gjallë që vetë fijet tematike të këtyre të fundit kishin ngjallur në rrethe letrare e filozofike të atyre kohërave.

Njerëz të cilëve jeta u shënohet nga fati, u diktohet nga vullneti i hyjnive, u pengohet a vështirësohet nga të njëjtat fatalitete, janë personazhe qendrore dhe në përpilimet e Haxhiademit, i cili evokon shkujdesjet njerëzore, mungesën e mprehtësisë ndaj kudogjendjes së perëndive, zemërimi i të cilave njihet trajtesa, regjistra përkatës gjuhësorë dhe traktate të plota që në kohë të autorëve më të rëndësishëm të botës antike.⁷ Janë nxitje të një ndjeshmërie të qartë përballjet e individit me birin për të cilin mendon pa u vetëdijësuar se një ditë do ta ketë para vetes, dhe pse personazhi në fjalë reflekton që në emër një domethënie të drejtpërdrejtë.⁸

Një meritë të madhe autori ynë ka pikërisht për faktin që duke pranëvënë trajta që në gjuhët klasike etimologjia natyrshëm i përafrojnë dhe i bënë pjesë të shtjellimit të subjekteve përkatëse, nuk humbet mundësinë që dhe në shqipe të jenë po aq të pranishme në vargje, të cilat marrin një plotësi të natyrshme dhe falë këtij fakti.⁹

⁶ Dhe pse nuk është çasti për t'u ndalur, shtypshkrimi përparoi në mënyrë paralele me një shfaqje të qartë interesi ndaj riprodhimit të kryeveprave të kësaj letërsie dhe një vëmendje e tillë, që më saktë mund të njëjtësohet me një periudhë a ndarje sinkronike në pikëpamje zhvillimi, dëshmon që në kulturën evropiane këto të fundit nuk kanë qenë jashtë objektit të hulumtimit e të dëshirës për ta lëvruar krejt mendësinë që qëmtohej në përmbajtjen e tyre.

⁷ E. Haxhiademi, *Ulisi, botim i cituar*, Tiranë, 1931, f.8: U bâft' ashtë si ti dëshirën ke./Ulis, për kte s'kam me t'u kundrështue; Por vetëm frika nuk më hiqet muë/ nga zemra, mbassi t'gjith'ata' qi shkuën/ në Troj' prej mbretënvet t'Greqís fituën/ Mënin e Jovit, atit t'perëndijvet,/ qi rrin n'Olimp në ball të gjith' hyjnvit:/ Kush ra në luftë, kush u mbyt nga deti, /Dhe vdekjen kush n'atdhë të tij e gjeti;/Mëni e perëndijvet t'gjith i shoi./ Sepse edhe Akili kshtu na shkoi/ nga bota: Apolloni tyk'e vrá/Me dor t'Paridit, qi veç donte grá.

⁸ Vetë emri i Telegonit (Τηλέγονος) e përmban në vetvete idenë a shënjimin e birit të lindur larg, në kundërvënje me Telemakun (ai që lufton larg), birin që Ulisit i kishte lindur nga Penelopa. Këtij të fundit i kushtohen pjesë të rëndësishme në veprën epike të Homerit kushtuar rrugëtimit tejet të gjatë të atit të tij, Ulisit, të konceptuara pikërisht në funksion të një parathënieje të ardhjes së tij në atdheun e vet. Personazhe të tilla janë pjesë e një skeme subjektore që del në dritë herë që në krye të shtjellimit të veprës, herë dhe në krejt vijimësinë e saj, por mbeten përherë artifice të plotësimit të idesë qendrore tematike apo të vetë heronjve kryesorë të veprës.

⁹ E. Haxhiademi, *Ulisi, Tragedi me pesë akte*, Berlin, 1924, botuar në Shtypshkronjën Luarasi, Tiranë, 1931, f. 30.

Veti të vyera të kësaj shkrimtarie mund të gjurmohen në jo pak variante veprash që duke i njohur dhe në vështrimin a rendin përkatës kronologjik, na ofrojnë një radhitje të arsyetuar që justifikon më tej dhe vetë rrjedhën e realizimit të krijimeve të autorit tonë.

I ndjeshëm ndaj kësaj problematike që gjuha origjinale në të cilën janë lëvruar prej kohësh të tilla argumente i bën më të interpretueshme në pikëpamje zbërthimi apo historie të fjalës, Haxhiademi, i sprovuar në pikëpamje të formës, ndërtimit dhe respektimi të një formimi që te metrika e prozodia shihte një faktor të rëndësishëm për lexueshmërinë e përpilimit, paraqitet dinjitoz dhe mbi të gjitha, një mjeshtër që kujdeset për brendinë dhe për elemente të përveçme që do të ruajnë lidhjet me variantet origjinare të motiveve që e kanë frymëzuar, duke qenë po aq themelore dhe për tekstin në gjuhën shqipe që bëjnë objekt vëzhgimi e vjeljeje nga ana jonë.

Duke rimarrë toposë të njohura në lidhje me personazhe dhe vepra, duke u paraqitur mjeshtëror në pranëvënie trajtash dhe ndërtimesh, Haxhiademi shfaqet në krejt madhësinë e thjeshtësinë e një autori që te antikiteti ka gjetur gurrën që nuk sherron lehtë kur ai që i përafrohet, performon me një vetëdije të qartë për traditën që po përjetëson nëpërmjet shkrimtarisë së vet.

Në këtë vështrim tonin për E.Haxhiademin si përçues kanonesh a elementesh institucionale në antikitet, nuk mund të mos vëmë në dukje ndër të tjera natyrshmërinë me të cilën ky autor kaq i vlerët trajton jetëshkrimin e autorëve të përzgjedhur dhe elemente qenësore të një bote si ajo romake.

Introduktimi i elementeve biografike të autorëve latinë, që mbetën dhe bashkautorë të një periudhe me rëndësi për historinë e Romës, e cila ka protagonistë të vetët shkrimtarë, mecenë, oratorë, politikanë e prijës të shquar, bën të mundur që të realizohet dhe ndërlidhja më se e domosdoshme mes gjuhës, letërsisë, qytetërimit, traditë që ka rezultuar mjaft fatlume dhe e dobishme në historikun e receptimit të gjuhëve klasike, në proces të studimit përkatës në shkollat më të mira evropiane. Me gjithë brishtësinë e personalitetit që Virgjili e ka reflektuar në një sërë rrethanash jetësore të risjella dhe nga njohës të veprës së tij, veprat e tij reflektojnë veçanësi në ndërtimin përkatës, por dhe në përfaqësimin e modelit gjinor që duhet gjurmuar në çdo element e veti përmbajtësore në njësi krijimi siç paraqitet ekloga apo libri. Përballja me veprat e Virgjilit ka kushtëzuar në mënyrë të pashmangshme mjaft studiues apo përkthyes të veprave të tij ndaj konsiderimit të domosdoshmërisë së kompetencës filologjike në interpretime dhe brendësime të ideve që jepen në vargje dhe të tilla sprova autori ynë i ka kapërcyer natyrshëm dhe me një lirshmëri unike.

Me shqipërimet e tij, por mbi të gjitha me transmetimin e ndjesive e frymëzimit që autorit tonë i vinin falë formimit të veçantë dhe në fushë të letrave klasike, ai ka vijuar e vijon t'i bëjë një shërbim të vyer edukimit

humanist të brezave, formësimi i të cilëve mbetet i paplotësuar pa njohuritë mbi antikitetin dhe periudhat më të rëndësishme historike të tij.

Duhet parë dhe si substrat kulturor ndikimi i qartë që institucionet që përçohen pikërisht përmes letërsisë antike kanë ushtruar në shkrimtarinë dhe projektet e punës së Haxhiademit, vërtet i ri në moshë, por mjaft i motivuar për të konkretizuar një formim kaq specifik të tijin në përpilime gjinore sa të veçanta, aq dhe objekt i një sërë vëzhgimesh, ndër të cilat vetë qenësia e një kulture unike si ajo e antikitetit përbën një përparësi më vete. Mund të flitet për kanone të cilat në një mënyrë ose tjetër Haxhiademi—autor i reflekton përmes personazhesh që dhe të emërtuar siç figurojnë në kryeveprat e klasikëve grekë, paraqiten me një profil të plazmuar prej talentit krijues të tij. Një vijimësi e qartë e kësaj njohjeje mund të vërehet në çështje të rikthimit të vëmendjes ndaj vetë receptimit të famës së personazheve të caktuara që janë qendrore në veprat me cilat dhe përfaqësohet letërsia antike greke, ndërkohë që në subjektet e Haxhiademit mbi këtë argument ndërtohen të tjera ngjarje dhe shtjellime, duke ruajtur gjithsesi individualitetin për të cilin këto personazhe ndërmenden në bëma, rrëfenja dhe legjenda.¹⁰

Kemi vlerësuar në këtë drejtim dhe ndërthurjen e natyrshme të elementeve të dy botëve në një shqipërim si ai i Bukolikeve të Virgjilit, të cilat dhe pse me një sërë veçantish që diktohen nga dukuri që kanë të bëjnë me origjinën e secilës dhe më tej me ecuritë që lidhen me një sërë faktorësh dhe historikë, përkojnë natyrshëm në sythet e komponimeve të këtij autori të periudhës së Augustit, që reflekton elemente të të dyja kulturave në kompozim, renditje, gërshetim tiparesh e veçorish që kanë të bëjnë dhe me gjininë e përzgjedhur prej tij.¹¹ Autori i Eneadës (po përdorim në këtë rasë emërtesën e zgjedhur e të përdorur shpesh nga Haxhiademi) përfaqësohet në historinë e letërsisë së

¹⁰ E cilësuar si tragjedi me pesë akte, vepërza “*Akili*” e E. Haxhiademit, botuar së pari në vitin 1931, mund të zbërthehet në disa segmente tekstore në të cilat personazhet nuk bëjnë tjetër veç i japin jetë një subjekti që mund të transmetojë një tjetër shpjegim të përfundimit të jetës së një personazhi unik në historinë e Greqisë së lashtë dhe pa të cilin as lufta e Trojës nuk do të kishte aq jehonë. Edhe kjo vepër e Haxhiademit, e introduktuar nga një “Parathëneje”, siç e cilëson ai tekstin hyrës e shpjegues, ka në krerë të caktuar analiza karakteriale që dëshmojnë dëshirën e vetë autorit për t’i portretizuar në mënyrën e vet personazhet më të përmendura në letërsinë antike greke, të shndërruara në protagonistë dhe në shpjegime të miteve përkatëse të botës greke.

¹¹ Shih gjithashtu dhe E. Haxhiademi, *Bukoliket*; pjesë e serisë kushtuar klasikëve, përgatitur për botim nga A. Leka, S. Leka, H. Haxhiademi (Pëllumbi), Botimet Poeteka, Tiranë, 2020. Shih sërish dhe E. Paci, “Profili kompleks i një shqipëruesi në një variant të Bukolikave të Vergilit (1932)”, në *Dramaturgu-poet Etëhem Haxhiademi në fokusin e trajtimeve letrare dhe gjuhësore*, Aktet e Konferencës shkencore, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2021.

shkruar latine dhe me të tilla përpilime, po aq reflektuese të lidhjeve të tij me një botë në ndryshim, që e përfshiu në disa dimensione dhe këtë të fundit.

Më së fundi, dhe për arsye se kolegë të nderuar kanë pasur objekt të qasjeve të tyre me shumë të drejtë dhe një kontekstualizim të kësaj shkrimtarie në një kuadër historik e socioletrar që pasuron së tepërmi e domosdoshmërisht panoramën diakronike të historisë së letërsisë së shkruar shqipe, do të doja t'i atribuojë autorit tonë një mirënjohje të sinqertë nga ana ime, për shtysën dhe motivimin për të parë sërish të tjera elemente të antropologjisë së antikitetit në vepërat e tij, të cilat jo më pak gjinden e gjurmohen dhe në shqipërime që e përfaqësojnë po aq me dinjitet Haxhiademin, i cili shkriu shumë prej energjive krijuese dhe në sjelljen e një vepre-model të njërit prej autorëve më të rëndësishëm të kohës së Augustit.

BIBLIOGRAFI

- Haxhiademi, E., *Ulisi, Tragedi me pesë akte*, Berlin, 1924, botuar në Shtypshkronjën Luarasi, Tiranë, 1931.
- Haxhiademi, E., *Akili, Tragedi me pesë akte*, Vjenë, 1926, botuar në Shtypshkronjën Luarasi, Tiranë, 1931.
- Haxhiademi, E., *Lyra (poezi)*, Botimet Poeteka, Tiranë, 2019.
- Haxhiademi, E., *Diomedi; tragjedi me pesë akte*, Botimet Poeteka, Tiranë, 2020.
- Haxhiademi, E., *Aleksandri; tragjedi me pesë akte*, Botimet Poeteka, Tiranë, 2020.
- Leka, A., “Etëhem Haxhiademi, vëzhguar përmes Parathanëjeve të tij, në Dramaturgu-poet Etëhem Haxhiademi në fokusin e trajtimeve letrare dhe gjuhësore”, në *Aktet e Konferencës shkencore*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2021.
- Marchetta, A., *Due studi sulle Bucoliche di Virgilio*, GEI editrice, Romë, 1994.
- Marone, Virgilio, *Le Bucoliche (per cura di C. Landi, con testo e commento)*, Le Monnier editore, Firenze, 1925.
- Maroni, P.V., *Bukoliket, përkëthye nga latinishtja prej Etëhem Haxhiademit*, Elbasan, 1922; botuar prej Shtypshkronjës Kristo P. Luarasi, Tiranë, 1932.
- Paci, E., “Për një studim të thelluar dhe përmbajtësor të elementeve institucionale të gjuhës latine”, në *Buletin shkencor*, Seria e Shkencave shoqërore, n. 68, Shkodër, 2018.
- Paci, E., “Për një vështrim antropologjik dhe gjuhësor të nocioneve themelore të botës romake dhe latine në tekstet universitare shqiptarë”, në *Buletin shkencor*, Seria e Shkencave shoqërore, n. 69, 2019.
- Paci, E., “Profili kompleks i një shqipëruesi në një variant të Bukolikave të Vergilit (1932)”, në *Dramaturgu-poet Etëhem Haxhiademi në fokusin e*

trajtimeve letrare dhe gjuhësore, Aktet e Konferencës shkencore, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2021.

Plangarica, T., *Univers i vlerave të munguara*, Botime Sejko, Tiranë, 2002.
Shtylla, B., “Tragjeditë e Haxhiademit”, në *Shkëndija*, nr. 4. Tiranë, 1941.

SUMMARY

THE REFLECTION OF THE INSTITUTIONS OF ANTIQUITY IN THE WRITING ACTIVITY OF E. HAXHIADEMI

In the Albanian translations of E. Haxhiademi, intertwined elements of the ancient Greek and Roman world can be traced. The classical formation of the author is reflected in aspects of form and content, and even more if we take into account the creation of the works under his signature, that are based on well-known motifs of ancient mythology. Even in the case of treating and placing in the center of the work characters that are fundamental in major events described in ancient Greek and Roman literature, the author stands out for a register of names and titles that are related to such a formation, special and unique in many respects.

In the works of Haxhiademi, titled and with the names of his own characters, such motifs, which are a combination of the essential elements of two worlds, can be traced in several aspects: in the metric construction, but also in the textual and substantive one. We point out these features in this synthetic treatment of ours, which was dedicated in particular to the reflection of the institutions of antiquity in the writing activity of the latter.